ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT

Kundër: MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**214-22-1548-2-2-1**
Nr i brendshëm	**214-22-017-221**

Sa i përket tenderit me titull:

"Mirëmbajtja e sistemit te menaxhimit te informatave ne laborator (LIMS) ne AKF"

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit

Emri: ASSECO SEE Sh.p.k

Adresa: Rr.Lidhja e Pejes No.177.

Prishtinë, 10000

Tel: +381 38 40 77 99

Ardian Shehu,
Drejtor Menaxhues

ardian.shehu@asseco-see.com

Data:
05 Maj 2022

asee by asseco
ASSECO SEE SH.P.K.
N. U.T. 810413620

(nënshkrimi dhe vula)

***Ankues mund të jetë pala e interesuar (operatori ekonomik apo grupi i operatorëve ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit).*

2. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Një përshkrim i shkurtër lidhur me datën dhe emrin e gazetës (ve) ditore në të cilën (at) është publikuar " Njoftimi për Kontratë" si dhe "Njoftimi për dhënie të Kontratës", afati i fundit për dorëzimin e tenderit, data dhe ora e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë është publikuar me datë: 07.03.2022 në faqen elektronike te KRPP-së: www.krpp.rks-gov.net. Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 29.03.2022, ora 11:00 Data e hapjes se tenderit: 29.03.2022, ora 11:00 Kriteri për dhënien e Kontratës: Tenderi ekonomikisht më i favorshëm Njoftimi per tenderuesin e eliminuar dhe njoftimi per dhenie te kontrates edhe publikuar me date: 21/04/2022. Vendimi lidhur me kerkesen per rishqyrtim eshte publikuar me date 29.04.2022

3. Procesi i Hapjes së tenderëve

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Nuk kemi marre pjese pasi cdo gje eshte online me e-prokurim.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po ☒ **Jo** ☐

Jemi njoftuar me shkrim nga AK lidhur me eliminimin tone permes letres standarde per tenderuesin e eliminuar. Konform nenit 108/A te Ligjit nr. 05/L-068 per plotesim dhe ndryshim te ligjit Nr.04/L-042 per Prokurim Publik. Me date 26.04.2022 kemi dorezuar kerkesen per rishqyrtim te vendimit prane AK ku i kemi shpreh mospajtimet tona lidhur me eliminim tone. Me date 29.04.2022 kemi pranuar vendimin per refuzim te kerkeses tone per rishqyrtim. Ne arsyetimin e dhene nga AK jepen te njejtat arsye

per eliminim, te cilat jane dhene ne letren standarde per tenderuesin e eliminuar, pa u adresuar te gjitha pikat tona mospajtuese te paraqitura ne kerkese.

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim:

Neni 72
Neni 6 i LPP-së;
Neni 59 paragrafi 2;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Neni 72 dhe 59.2 lidhur me nenin 6 te LPP-se:

Ne baze te letres standarde per tenderuesin e eliminuar, perkatesisht ne arsyetimin e saj, shihet qarte se te dy arsyet per eliminim te OE ankues kane te bejne me mungese sqarimesh te cilat kane pasur mundesi te plotesohen sikur AK te kerkokne nga OE ankues.

Mungesa e autorizimit te zyrtarit pergjegjes per nenshkrim te ofertave/tendereve te OE ankues dhe mungesa e kontratave te punes per vitet paraprake per punonjesit e kerkuar ka mundur shume lehte te sqarohet nese AK do te shfrytezonte te drejten dhe mundesite ligjore nga neni 59.2 dhe neni 72 i Ligjit per Prokurim Publk per te kerkuar informata dhe sqarime shtese nga OE ankues. Aq me teper nese kesaj i shtohet detyrimi i AK nga neni 6 i LPP-se qe te sigurohet qe fondet publike te perdoren ne menyren me ekonomike ne menyre qe te shmanget oferta me çmim me te larte, siç ka ndodhur ne rastin konkret.

Per dijeni te AK dhe komisionit vleresues, OE ankues eshte kompani me kapital nderkombetar me standarde dhe procese te punes te certifikura nderkombetarisht, prandaj ne asnje menyre nuk mund te ndodh qe nje punonjes i saj te nenshkruaj per dhe ne emer te saj pa qene person i autorizuar, qofte permes ligjit/statutit apo permes autorizimit/prokures se posaçme. Ne rastin konkret, natyrisht qe personi qe ka nenshkruar per dhe ne emer te ASSECO SEE ka autorizim te posaçem per perfaqesim te ASSECO SEE ne procedura te prokurimit, meqe pozita e saj nderlidhet kryesisht me pergatitje te ofertave per pjesemarrje ne aktivitete te prokurimit. Mirepo, duke marre per baze praktiken e deritanishme, qe asnjehere nuk eshte kerkuar autorizimi si deshmi e bashkangjitur ne oferten e tenderuesit, edhe ne kete rast OE ankues nuk e ka bashkangjitur. Prandaj e gjithe kjo "paqartesi" ka mund te eliminohet fare lehte nese AK do te kerkonte sqarime shtese sipas mundesive ligjore nga neni 59.2 dhe 72 i LPP-se.

Ngjashem eshte situata edhe me deshmite e pervojes se punes per stafin e angazhuar ne kete projekt. Ne oferten e dorezuar nga OE ankues eshte bashkangjitur kontrata e vitit aktual, meqe kontrata jane 1 vjeçare dhe çdo vit hartohen kontrata te reja per shkak te ndonje ndryshimi eventual, si dhe CV-te e tyre ne te cilen shihet qarte se te njejtit jane te angazhuar ne ASSECO SEE me shume 3 (tre) vite. Nese AK do te kishte per qellim qe te sqaronte dilemat per te cilat e ka eliminuar OE ankues atehere edhe ne kete rast do te duhej te shfrytezohej mundesia e kerkeses per informata shtese qe jep Ligji per Prokurim Publik.

Per fund, duke qene se aryset e eliminimit te OE ankues jane krejtesisht per shkak te mungeses se sqarimeve ne mes te AK dhe OE ankues dhe nuk ndikojne ne permbajtje te ofertes, dhe duke marre per baze dallimin ne oferten financiare te OE fitues dhe OE ankues, konsiderojme se AK e ka mundesine qe te shfrytezoj te drejen ligjore per te kerku informata dhe sqarime te nevojshme nga OE ankues ne menyre qe te mos t'ia humb te drjeten OE ankues per te fituar kete kontrate dhe njekohesisht qe te perdore fondet publike ne menyren me ekonomike duke kursyer buxhetin publik per afer 10,000.00 EUR. Prandaj, AK pas shqyrtimit te kerkeses per rivleresim duhet miratoj kerkesen si te bazuar, te anuloj ne teresi vendimin per dhenie te kontrates dhe te beje rivleresimin e tendereve.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Shkeljet e supozuara kane rezultuar me mosfitim te kontrates ne fjale dhe rrjedhimisht mos arketim te kesja shume ne buxheti tone. Gjithashtu, per te permbushur nevojat e kesaj kontrate, ne kemi dedikuar nje pjese te stafit aktual te cilin tani do ta kemi problem ta risistemojme ne projekti tjera.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë".
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës".
c) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe
d) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
e) një kopje të vendimit të miratuar nga autoriteti kontraktues gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

DATË/A:	29.04.2022
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	**Asecoo SEE shpk rr. Lidhja e Pejes nr.177 , Prishtinë**
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	**e-prokurimit**
NGA/OD/FROM:	**Agim Islami** **Zëvendsues Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit- MPB**
TE MA/ SUBJEKAT/SUBJECT:	**Vendim në Kërkesën për Rishqyrtimi për Aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator"**

Ministria e Punëve të Brendshme, duke vendosur sipas Kërkesë për Rishqyrtimi të Tenderuesit, Asecoo SEE shpk, rr. Lidhja e Pejes nr.177 , Prishtinë, të datës 26/04/2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit me Titull: "Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator", me numër prokurimi: 214-22-1548-2-2-1, Numri i brendshëm: 214 22 017 221, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 21/04/2021 në platformën elektronike, AK, mbështetur në Ligjit nr. *Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*, neni 108/A, nxjerr këtë:

VENDIM

I. REFUZOHET kërkesa për rishqyrtim e tenderuesit Asecoo SEE shpk ,Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator", me numër prokurimi: 214-22-1548-2-2-1, Numri i brendshëm: 214 22 017 221, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 21/04//2022.

Autoriteti Kontraktues - MPB-ja, për këtë aktivitet të prokurimit me procedurë të hapur, ka publikuar Njoftimin për kontratë, në sistemin elektronik e-prokurimi të KRPP-së me datën 07/03/2022, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte 29.03.2022.

Pas publikimit te Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 26/04/2022 kemi pranuar Kërkesë për Rishqyrtim nga Asecoo SEE shpk , Prishtinë,:

PRETENDIMET ANKIMORE

Tenderuesi Asecoo SEE shpk ,Prishtinë,, si pale e pakënaqur ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim tek AK me datën 26/04/2025, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 21/04/2022, për tenderin, ""Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator", duke pretenduar së janë bere shkelje të dispozitave të LPP, Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237 dhe ligjin Nr. 05/L-068, siç janë:

Dispozitat e shkelura të Ligjit të Prokurimit Publik sipas Asecoo SEE, Prishtinë, është si vijon:

Neni 6 –
Neni 59.2 -
Neni 72–

Detale dhe argumente për pikat ankimore :

1. Autoritetin Kontraktues -Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton se pretendimi i tenderuesit ankues, qe eshte shkelur neni 59.2 i LPP-së *Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve*, është i pabazuar, sepse, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 po citoj: "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

1. Autoritetin Kontraktues -Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton se pretendimi i tenderuesit ankues, qe eshte shkelur neni 72 i LPP-së Autoritetin Kontraktues -Ministria e Punëve të Brendshme, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues është i pabazuar, sepse AK, gjatë procesit të vlerësimit ka respektuar nenin 72 te LPP . Sa per informat neni 72 perdoret vetëm per : Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, **dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.**
Gjithashtu ,*duke u bazuar ne interpretimin e KRPP-se:*
Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga

personi kompetent , nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj.) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.?

Andaj me te drejt komisioni i vlersimit te ofertave ka vendosur per eliminimin e kompanis tuaj.

Konkluzion:

I. Refuzohet Kërkesa për Rishqyrtim e tenderuesit **Asecoo SEE shpk ,Prishtinë, e pa BAZUAR,** kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 21/04/2022 në platformën e e-prokurimit për tenderin ""Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator", me numër prokurimi: 214-22-1548-2-2-1, Numri i brendshëm: 214 22 017 221

II. Mbetet në fuqi Njoftimit mbi vendimin e AK-MPB të publikuar me datën 21/04/2022 -Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e ""Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator", me numër prokurimi: 214-22-1548-2-2-1, Numri i brendshëm: 214 22 017 221.

III. AK, vazhdon tutje me aktivitetit e prokurimit ""Mirëmbajtja se sistemit te menaxhimit te informateve ne laborator", me numër prokurimi: 214-22-1548-2-2-1, Numri i brendshëm: 214 22 017 221.

IV. Autoriteti Kontraktues nga provat e prezantuara me lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

- **Këshille juridike:**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankese pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohen brenda dhjetë (10) ditëve pas këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. 1 x 1 **Asecoo SEE shpk** , Prishtinë
2. Te gjitha palve te interesuar
3. 1 x 1 e-prokurimit të MPB-ës.